



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.844/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevci kryesues, Afijete Sada - Glllogjani, Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Isuf Osmani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet i pabazuar apeli Anr.844/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Isuf Osmani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, në pjesën me të cilën ka kërkuar rinumërimin, 1801X/02R, 1804E/02R, 1806E/01D, 1808E/01R, 1810E/01R, 1819E/01R, 1819E/02R, 1122E/01R, 1822E/02D, 1824E/06R, 1833E/02D, 1834E/02D, 1840E/01D.

II. Hudhet i pa lejuar apeli Anr.844/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Isuf Osmani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, në pjesën me të cilën ka kërkuar rinumërimin e vendvotimeve: 1801E/01R, 1801X/03R, 1801X/04R, 1802E/03R, 1802X/01R, 1802X/02R, 1803E/01R, 1803E/02R, 1803E/03D, 1803E/02R, 1803E/03D, 1804E/03D, 1805E/01D, 1808E/01R, 1808E/02D, 1810E/02D, 1811E/01D, 1812E/02R, 1812E/03R,

1813R/02D, 1814E/03D, 1816E/02R, 1817E/01R, 1817E/02D, 1818E/01R, 1818E/02D, 1819E/03D, 1820E/01R, 1820E/02R, 1820E/03R, 1821E/01D, 1824E/01R, 1824E/03R, 1824E/05R, 1824E/07R, 1824E/09R, 1824E/12R, 1824E/13R, 1824E/14R, 1827E/02R, 1828E/01D, 1829E/02D, 1831E/02D, 1834E/01R, 1835E/01D, 1837E/01R, 1837E/02D, 1838E/01D, 1839E/02D, 1841E/02D, 1844E/01D.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.844/2021, i ushtruar nga Isuf Osmani Kandidat për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevë, me të cilën pretendon se sipas dyshimit të bazuar se ka pasur parregullsi në shumë vendvotime në Komunën e Podujevës. Bashkangjitur me apel i ka bashkangjitur vendvotimet 1801E/01R, 1801X/03R, 1801X/04R, 1802E/03R, 1802X/01R, 1802X/02R, 1803E/01R, 1803E/02R, 1803E/03D, 1803E/02R, 1803E/03D, 1804E/03D, 1805E/01D, 1808E/01R, 1808E/02D, 1810E/02D, 1811E/01D, 1812E/02R, 1812E/03R, 1813R/02D, 1814E/03D, 1816E/02R, 1817E/01R, 1817E/02D, 1818E/01R, 1818E/02D, 1819E/03D, 1820E/01R, 1820E/02R, 1820E/03R, 1821E/01D, 1824E/01R, 1824E/03R, 1824E/05R, 1824E/07R, 1824E/09R, 1824E/12R, 1824E/13R, 1824E/14R, 1827E/02R, 1828E/01D, 1829E/02D, 1831E/02D, 1834E/01R, 1835E/01D, 1837E/01R, 1837E/02D, 1838E/01D, 1839E/02D, 1841E/02D, 1844E/01D, 1801X/02R, 1804E/02R, 1806E/01D, 1808E/01R, 1810E/01R, 1819E/01R, 1819E/02R, 1122E/01R, 1822E/02D, 1824E/06R, 1833E/02D, 1834E/02D, 1840E/01D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli në pikën I të dispozitivit është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, kërkon rinumërimin e votave për vendvotimet 1801X/02R, 1804E/02R, 1806E/01D, 1808E/01R, 1810E/01R, 1819E/01R, 1819E/02R, 1122E/01R, 1822E/02D, 1824E/06R, 1833E/02D, 1834E/02D, 1840E/01D, është i pa bazuar për faktin se për të njëjta vendvotime, KQZ-ja veç e ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati

përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtat vendvotime të rinumëruara nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm, për më tepër ankuesi nuk ka ofruar prova shkresore që do ta argumenton se parregullsitë kanë ndodhur me rastin e rinumërimit andaj si të tilla këto pretendime janë të paqëndrueshme.

Paneli përfundimisht vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, pasi që të njëjtat vendvotime janë të rinumëruar dhe me rinumërimin e tyre është rregulluar çdo parregullsi. Edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete.

Apeli në pikën II të dispozitivit Hudhet i pa lejuar

Sa i përket pikës II të dispozitivit, paneli pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha vendvotimeve, erdhi në përfundim se për vendvotimet 1801E/01R, 1801X/03R, 1801X/04R, 1802E/03R, 1802X/01R, 1802X/02R, 1803E/01R, 1803E/02R, 1803E/03D, 1803E/02R, 1803E/03D, 1804E/03D, 1805E/01D, 1808E/01R, 1808E/02D, 1810E/02D, 1811E/01D, 1812E/02R, 1812E/03R, 1813R/02D, 1814E/03D, 1816E/02R, 1817E/01R, 1817E/02D, 1818E/01R, 1818E/02D, 1819E/03D, 1820E/01R, 1820E/02R, 1820E/03R, 1821E/01D, 1824E/01R, 1824E/03R, 1824E/05R, 1824E/07R, 1824E/09R, 1824E/12R, 1824E/13R, 1824E/14R, 1827E/02R, 1828E/01D, 1829E/02D, 1831E/02D, 1834E/01R, 1835E/01D, 1837E/01R, 1837E/02D, 1838E/01D, 1839E/02D, 1841E/02D, 1844E/01D, apeli të hudhet si i pa lejuar. Në rastin konkret për këto vendvotime, kemi të bëjmë me çështje e **gjykuar “res iudicata”**, për faktin se për të njëjtat është vendosur me Vendimin Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, andaj kjo pjesë e ankesës është hudhur si e pa lejuar, në bazë nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, nenit 6.4 pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se për pjesën I të dispozitivit

vendvotimet e pretenduara për parregullsi janë rinumëruar, ndërsa për pikën II, janë çështje e gjykuar “res iudicata”.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, nenit 6.4, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.844/2021 më datën 05.11.2021**



**Kryesues e Panelit
Adnan Konushevc**

***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*